



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

**PËRCAKTIMIN E FAKTORËVE TË RISKUT QË PËRFSHIHEN NË PËRLLOGARITJEN
E PRIMIT PËR PRODUKTET E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË SEKTORIN E
TRANSPORTIT**

Miratuar me Vendim Bordi nr. 156, datë 19.09.2024

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore ka për objekt:

1. Hartimin e rregullave për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përllogaritjen e primit të sigurimit në sektorin e transportit në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik;
2. Përcaktimin e metodologjisë që do të përdoret në aplikimin e faktorëve të riskut, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit nga Autoriteti;
3. Mënyrën e raportimit të shoqërive të sigurimit në Autoritet.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe të nenit 7, pika 3, të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “*Aktuari i autorizuar*” është personi i licencuar nga Autoriteti, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.
2. “*Autoritet*” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
3. “*Baza teknike e të dhënave*” është tërësia e të dhënave në lidhje me procesin e marrjes në sigurim, menaxhimin e dëmeve, treguesve statistikorë dhe supozimeve aktuariale, demografike, financiare, etj., të përdorura në vlerësimet aktuariale.
4. “*Faktorë risku*” janë faktorët që bëjnë të mundur diferencimin e primit të sigurimit në bazë të disa karakteristikave të përcaktuara në këtë rregullore.
5. “*Ngarkesat mbi primin e rrezikut*” përfshijnë shpenzimet e marrjes në sigurim, shpenzimet administrative, përfshirë komisionet, si dhe pjesën e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit.
6. “*Primi i rrezikut*”, për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, është pjesa e primit të sigurimit të vlerësuar (i) për të mbuluar dëmet sipas parashikimeve të përcaktuara në kontratën e sigurimit dhe (ii) për të financuar kontributin e shoqërisë së sigurimit në fondin e kompensimit.
7. “*Primi i sigurimit*” përbëhet nga primi i rrezikut si dhe ngarkesat mbi primin e rrezikut.
8. “*Provigjoni teknik i primit të pafituar*” është shuma e llogaritur sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.
9. “*Shoqëria*” është shoqëria e sigurimit e licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e sigurimeve.

Neni 4

Baza teknike e të dhënave për hartimin e tabelave të primit të sigurimit

1. Në hartimin e tabelave të primit të rrezikut si dhe në përcaktimin e primit të sigurimit, shoqëria e sigurimit bazohet në bazën teknike të të dhënave për një periudhë që përfshin të paktën 5 vitet e fundit. Baza teknike e të dhënave duhet të përfshijë edhe të dhënat për dëmet e regjistruara për llogari të fondit të kompensimit për periudhën që merret në shqyrtim.
2. Rregullat për vlerësimin e primit të rrezikut, raportimin dhe miratimi nga ana e Autoritetit, përcaktohen në rregulloren për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
3. Baza e të dhënave, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajë minimalisht:
 - a) të dhëna mbi dëmet e ndodhura (paguar dhe pezull). Këto të dhëna të grupohen për vit aksidenti në numër dhe në vlerë në nivel agregat dhe në mënyrë analitike.
 - b) të dhëna të vlerësuar, në numër dhe në vlerë, për dëmet e ndodhura, por të pa raportuara (IBNR) dhe të ndara për vit aksidenti.
 - c) të dhëna, në numër dhe vlerë, në lidhje me dëmet në proces gjyqësor, të ndara sipas shkallëve të gjykimit dhe vitit të aksidentit.

- d) të dhëna, në lidhje me dëmet e ndodhura, në numër dhe vlerë për vit aksidenti, të ndara në dëme ndaj personit dhe dëme ndaj pronës. Për dëmet ndaj personit të kryhet dhe një nënndarje në dëme pasurore dhe dëme jopasurore.
- e) të dhëna analitike mbi kontratat e nënshkruara (policat e lëshuara). Këto të dhëna të grupohen për vit ekspozimi, në numër dhe në vlerë.
- f) të dhëna në lidhje me kontratat e nënshkruara (policat e lëshuara), të grupuara për vit ekspozimi sipas fuqisë motorike dhe vjetërsisë së mjetit.
- g) të dhëna në lidhje me kontratat e nënshkruara (policat e lëshuara), të grupuara për vit ekspozimi sipas grupmoshave të të siguruarve dhe eksperiencës së përdoruesit të mjetit.
- h) të dhëna në lidhje me kontratat e nënshkruara (policat e lëshuara), të grupuara për vit ekspozimi sipas distancës vjetore të përshkuar dhe qarkut të regjistrimit të mjetit.

Neni 5

Faktorët e riskut që zbatohen nga shoqëritë e sigurimit

1. Në përlllogaritjen e primit të sigurimit shoqëria e sigurimit zbaton këto faktorë kryesorë risku:
 - a) Historiku i dëmeve, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit.
 - b) Fuqia motorike;
 - c) Mosha e të siguruarit;
 - d) Eksperienca në drejtimin e mjetit motorik;
 - e) Përdorimi i mjetit: subjekt, individ;
 - f) Qarku i regjistrimit të mjetit;
 - g) Vjetërsia e mjetit.
2. Shoqëria e sigurimit mund të zbatojë edhe faktorë të tjerë risku, përveç atyre të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Shoqëria e sigurimit zbaton faktorët e riskut në përlllogaritjen e primit të sigurimit për kategorinë e autoveturave të produktit të sigurimit të detyrueshëm motorik, MTPL e brendshme.
4. Faktorët e riskut të sipërcituar nuk aplikohen për sigurimin kufitar dhe atë të kartonit jeshil.

Neni 6

Përcaktimi dhe aplikimi i tarifave të primit të sigurimit të detyrueshëm

1. Shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë rregullore.
2. Shoqëria e sigurimit në përcaktimin e tarifave të primit të sigurimit bazohet në bazat teknike të të dhënave, faktorët e riskut dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e primeve të sigurimit, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë.
3. Raporti i aktuarit në lidhje me tarifat e reja të primit duhet të përfshijë një përshkrim dhe vlerësim të bazave teknike të të dhënave të përdorura, procedurave të ndjekura për përlllogaritjen e primit të sigurimit, tabelave të tarifave dhe opinionin mbi tarifat të shoqëruar me materiale mbështetëse.

4. Tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm nuk mund të ndryshohen më shumë se dy herë brenda një viti kalendarik.
5. Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, urdhëron rishikimin e tarifave të reja të primeve, nëse konstaton se baza e të dhënave për hartimin e tabelave të primit të sigurimit nuk është e saktë, ose shoqëria e sigurimit nuk ka vepruar në përputhje me parimet aktuariale dhe metodologjinë e përdorur për përfshirjen e faktorëve të riskut të përcaktuar me këtë rregullore.
6. Shoqëria e sigurimit nuk mund të aplikojë tarifa të primit të sigurimit të ndryshme nga ato të raportuara në Autoritet.

Neni 7 Detyrimi për njoftim

1. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara aplikimit të tarifave të reja të primit.
2. Shoqëria e sigurimit së bashku me njoftimin për aplikimin e tarifave të reja të primit, depoziton pranë Autoritetit bazën teknike të të dhënave, faktorët e riskut dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e primeve të sigurimit, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë, të paraqitur në formën e një raporti me shkrim.

Neni 8 Përfshirja e faktorëve të riskut në përllogaritjen e primit të sigurimit

1. Për përllogaritjen e primit të sigurimit bazuar në faktorët e riskut, shoqëria e sigurimit fillimisht përllogarit primin e sigurimit në nivel kategorie dhe më pas vlerën e përfutur e shpërndan në nënkategoritë përkatëse bazuar në klasifikimin e faktorëve të riskut.
2. Në formulë primi i sigurimit për kategori paraqitet si vijon:

$$P_{S,K} = \frac{P_{R,K}}{(1-(\alpha+\beta+\gamma))} \quad (1)$$

ku

- $P_{S,K}$ përfaqëson primin e sigurimit për kategori;
- $P_{R,K}$ përfaqëson primin e rrezikut për kategori;
- α, β, γ përfaqësojnë shpenzimet e marrjes në sigurim, shpenzimet administrative dhe marzhin e pritshtëm të fitimit të shoqërisë.

Primi i sigurimit, bazuar në faktorët e riskut, përftohet si vijon:

$$P_{S,FR} = P_{S,K} \cdot h_D \cdot g_j \cdot m_i \cdot n_e \cdot P_{s,i} \cdot Q_p \cdot V_m \cdot F_{tj} \quad (2)$$

ku

- $P_{S,FR}$ përfaqëson primin e sigurimit bazuar në faktorët e riskut;
- h_D përfaqëson faktorin e riskut *Historiku i dëmeve për të siguruarin, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit*;

- g_j përfaqëson faktorin e riskut *fuqia motorike*;
 - m_i përfaqëson faktorin e riskut *mosha e të siguruarit*;
 - n_e përfaqëson faktorin e riskut *eksperiencia në drejtim të mjetit motorik*;
 - $P_{s,i}$, përfaqëson faktorin e riskut *Përdorimi i mjetit: subjekt, individ*;
 - Q_p , përfaqëson faktorin e riskut *Qarkun e regjistrimit të mjetit*;
 - V_m , përfaqëson faktorin e riskut *Vjetërsia e mjetit*.
 - F_{tj} , përfaqëson faktorë të tjerë risku, përveç këtyre të parashikuara në këtë rregullore, të zbatuar nga shoqëria e sigurimit.
3. Mënyra e zbatimit të faktorëve të riskut, si dhe diapazoni i vlerave që marrin këto faktorë, përcaktohen sipas aneksit bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Neni 9

Publikimi i koeficientëve të faktorëve të riskut dhe i primeve

1. Shoqëria e sigurimit publikon në faqen zyrtare të internetit, gjatë gjithë periudhës së zbatimit, koeficientët e faktorëve të riskut, shoqëruar me raste të zbatimit të tyre në praktikë, si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
2. Shoqëria e sigurimit mban të afishuara në çdo pikë të shitjes së saj, tabelat me primet e sigurimit, të miratuara gjatë periudhës së zbatimit të tyre.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 janar 2025

Aneks

Metodologjia e përdorur për përfshirjen e faktorëve të riskut

Shoqëria e sigurimit, për kategorinë autovetura, përllogarit primin e sigurimit bazuar në faktorët e riskut si më poshtë:

- a) Historiku i dëmeve, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit;
- b) Fuqia motorike;
- c) Mosha e të sigurvearit;
- d) Eksperienca në drejtimin e mjetit motorik;
- e) Përdorimi i mjetit: subjekt, individ;
- f) Qarku i regjistrimit të mjetit;
- g) Vjetërsia e mjetit.

Për përllogaritjen e primit të sigurimit bazuar në faktorët e riskut, shoqëria e sigurimit në fillim përllogarit primin e sigurimit në nivel kategorie, në vijim vlerën e përftuar e shpërndan në nënkategoritë përkatëse bazuar në klasifikimin e faktorëve të riskut.

Në formulë primi i sigurimit për kategori paraqitet si vijon:

$$P_{S,K} = \frac{P_{R,K}}{(1-(\alpha+\beta+\gamma))} \quad (1)$$

ku

- $P_{S,K}$ përfaqëson primin e sigurimit për kategori;
- $P_{R,K}$ përfaqëson primin e rrezikut për kategori;
- α, β, γ përfaqësojnë shpenzimet e marrjes në sigurim, shpenzimet administrative dhe marzhin e pritshëm të fitimit të shoqërisë.

Primi i sigurimit, bazuar në faktorët e riskut, përftohet si vijon:

$$P_{S,FR} = P_{S,K} \cdot h_D \cdot g_j \cdot m_i \cdot n_e \cdot P_{s,i} \cdot Q_p \cdot V_m \cdot F_{tj} \quad (2)$$

ku

- $P_{S,FR}$ përfaqëson primin e sigurimit bazuar në faktorët e riskut;
- h_D përfaqëson faktorin e riskut *Historiku i dëmeve për të sigurvearin*, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit, dhe indeksi d ndahet në tre klasa si vijon:

	Klasa	Vlerat e koeficientëve
I.	Asnjë dëm të raportuar gjatë vitit	0.95 deri në 0.98
II.	Një dëm të raportuar gjatë vitit	deri në 1.25
III.	Dy ose më shumë dëme të raportuara gjatë tre viteve të fundit	deri në 1.5

Në rast se shkaktari i aksidentit është i ndryshëm nga i siguruari në emër të të cilit është i siguruar mjeti motorik, faktori i riskut “Historiku i dëmeve” do të zbatohet për të siguarin, si dhe shkaktarin e aksidentit.

Për vitin e parë të zbatimit të kësaj rregulloreje faktori i riskut “Historiku i dëmeve”, h_D është i barabartë me 1.

Për pronarët/përdoruesit e mjetit motorik të cilët sigurohen për herë të parë, faktori i riskut “Historiku i dëmeve”, h_D është i barabartë me 1.

- g_j përfaqëson faktorin e riskut *fuqia motorike* dhe indeksi j ndahet në shtatë klasa. Klasat e faktorit paraqiten si më poshtë:

	Klasa	Vlerat e koeficientëve
I.	deri në 1300 cm ³	deri në 0.92
II.	nga 1301 deri në 1600 cm ³	deri në 0.95
III.	nga 1601 deri në 1800 cm ³	0.97 deri në 1.02
IV.	nga 1801 cm ³ deri në 2000 cm ³	deri në 1.05
V.	nga 2001 cm ³ deri në 2500 cm ³	deri në 1.1
VI.	nga 2501 cm ³ deri në 3000 cm ³	deri në 1.15
VII.	mbi 3000 cm ³	deri në 1.25

- m_i përfaqëson faktorin e riskut *mosha e të siguararit*. Indeksi i ndahet në dy klasa si vijon:

	Klasa	Vlerat e koeficientëve
I.	18 deri në 21 vjeç	deri në 1.15
II.	Të tjerë	1

- n_e përfaqëson faktorin e riskut *eksperienca në drejtim të mjetit motorik*. Për të siguarit të ndryshëm nga 18 deri në 21 vjeç, indeksi e ndahet në dy klasa si vijon:

	Klasa	Vlerat e koeficientëve
I.	Deri në dy vite	deri në 1.15
II.	Mbi dy vite	1

- $P_{s,i}$ përfaqëson faktorin e riskut *Përdorimi i mjetit: subjekt, individ*. Indeksi ndahet në dy klasa si vijon:

	Klasa	Vlerat e koeficientëve
I.	Individ	1
II.	Subjekt	deri në 1.2

Për subjektet do të zbatohen faktorët: përdorimi i mjetit, fuqia motorike, qarku i regjistrimit të mjetit, si dhe vjetërsia e mjetit.

- Q_p , përfaqëson faktorin e riskut *Qarku i regjistrimit të mjetit*. Indeksi ndahet në dy klasa si vijon:

	Klasa	Vlerat e koeficientëve
I.	Berat, Dibër, Kukës	deri në 0.97
II.	Të tjera	1

- V_m , përfaqëson faktorin e riskut *Vjetërsia e mjetit*. Indeksi ndahet në katër klasa si vijon:

	Klasa	Vlerat e koeficientëve
I.	deri në 5 vjet	0.98
II.	nga 6 deri në 10 vjet	deri në 1
III.	nga 11 deri në 15 vjet	deri në 1.02
IV.	mbi 15 vjet	deri në 1.05

- F_{tj} , përfaqëson faktorë të tjerë risku, përveç këtyre të parashikuara në këtë rregullore, të zbatuar nga shoqëria e sigurimit. Indeksi tj merr vlera në $j = 0, \dots, n$.